



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes



Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr.09/2022 për Atashetë e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes shpall:

KONKURS I BRENDSHËM
Për përzgjedhjen e Përfaqësuesve Ushtarak

Titulli i pozitës:

1. Përfaqësues Ushtarak/Oficer Ndërlidhës i FSK-së në Ajrovë / SHBA

2. Përfaqësues Ushtarak/Oficer i FSK-së në Gjermani USAREUR-AF

Detyrat dhe përgjegjësitë e Përfaqësuesit Ushtarak / SHBA;

- Të këshillojë Shefin e Misionit Diplomatik, për çështje të mbrojtjes dhe sigurisë;
- Të përfaqësojë në shtetin pritës ose në organizatat ndërkombëtare Republikën e Kosovës, Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, për çështje të mbrojtjes dhe sigurisë;
- Të ndjekë dhe të fuqizojë zhvillimin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet Republikës së Kosovës me strukturat përkatëse të shtetit pritës;
- Të ndjekë zhvillimet në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë të shtetit pritës dhe në veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare, pranë të cilave është akredituar dhe të informojë Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- Të bashkëpunojë me strukturat përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e Forcave të Armatosura të vendit pritës për përgatitjen dhe zhvillimin e bisedimeve, takimeve, mbledhjeve, nënshkrimit e marrëveshjeve, pritjen e delegacioneve e të tjera;
- Të bashkërendojë, të ndjekë dhe të informojë DBNIE-A në MM lidhur me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet, planet, programet e bashkëpunimit dypalësh/shumëpalësh me shtetin/organizatën ku është akredituar;
- Të kërkojë autorizim paraprak nga DBNIE-A për të gjitha udhëtimet të cilat nuk janë paraparë në planin e punës. DBNIE-A pas konsultimit paraprak me Ministrinë e njofton PU-në lidhur me kërkesën e tij.
- Të komunikojë, të koordinojë dhe të sinkronizojë veprimet që lidhen me ekzekutimin e aktiviteteve të planifikuara në planet dypalëshe apo aktivitete të planifikuara jashtë planit dypalësh me DBNIE-A;
- Të bëjë organizimin e ceremonisë me rastin e shënimit të Ditës së Forcës, dhe ceremonive të tjera, bazuar në buxhetin e planifikuar;
- Të bëjë përgatitjen për realizimin e vizitave të autoriteteve të larta civile dhe ushtarake nga MM-ja/FSK-ja në vendin /organizatën ku është akredituar /shërben;
- Të zbatojë dispozitat e Kodit Disiplinor dhe Kodit të Etikës në rast të shkeljeve nga stafi nën varësi;

- Të kërkojë nga MM-ja/FSK-ja largimin e pjesëtarit të FSK-së nga shteti pritës në rastet kur vlerëson se veprimet e pjesëtarit përbëjnë shkelje të autorizimeve apo rregullave të përcaktuara;
- Të shprehë vetëm qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës sipas koordinimit paraprak me Shefin e Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës.
Përveç detyrave të përcaktuara, PU është përgjegjës të:
- Planifikon, koordinon dhe ndihmon pjesëmarrjen e FSK-së dhe Gardën Kombëtare të Ajrovës (GKA) në aktivitetet e përbashkëta;
- Koordinon me GKA, DBNIEA, USMILGP dhe Atasheun e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës në SHBA, si dhe/apo shtetet tjera në mënyrë që të kryhen të gjitha procedurat administrative dhe diplomatike të lëvizjes së trupave.
- Asiston stafin e FSK-së para, gjatë dhe pas procesit të pjesëmarrjes nëpër konferenca/stërvitje si dhe sigurohet që të kenë qasjen përkatëse në informacion (sipas nivelit të klasifikimit të informacionit).
- Merr pjesë në punëtori, aktivitete, konferenca dhe angazhime të tjera në emër të FSK-së duke përfaqësuar interesat e Forcës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Përfaqësuesit Ushtarak / Gjermani;

- Planifikon, koordinon dhe ndihmon pjesëmarrjen e FSK-së në ushtrimet e USAREUR-AF dhe ato të EUCOM-it.
- Rekomandon, koordinon dhe organizon vizitat e nivelit të lartë komandues dypalësh në mes të FSK-së dhe USAREUR-AF.
- Planifikon, koordinon dhe organizon pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve tjera të FSK-së në USAREUR-AF.
- Koordinon dhe menaxhon zhvillimin e planit të stërvitjeve në linjë me objektivat e KOMFSK-së, të Shtabit të Përgjithshëm, komandave të FSK-së, dhe në përputhje me objektivat e ndërvoprueshmërisë së USAREUR-AF.
- Është përgjegjës për koordinim dhe mbështetje të planifikimit, menaxhimit, ekzekutimit dhe përcjellje të APV-ve të njësisë të FSK-së në ushtrimet e organizuara nën ombrellën e USAREUR-AF dhe/ose EUCOM.
- Rekomandon formatin, numrin dhe llojin e ushtrimeve të organizuara nga USAREUR-AF në të cilat FSK duhet të marrë pjesë bazuar në objektivat e stërvitjes. Pas miratimit nga autoriteti relevant, sigurohet që të gjitha angazhimet e njësisë të FSK-së janë të pasqyruara në kalendarët e stërvitjeve të USAREUR-AF para, gjatë dhe pas CTC-së.
- Koordinon me USAREUR-AF, DBNIEA, ODC-në, Atasheun e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës në SHBA dhe në Gjermani si dhe/apo shtetet tjera në mënyrë që të kryhen të gjitha procedurat administrative dhe diplomatike të lëvizjes së trupave.
- Asiston oficerët planifikues para, gjatë dhe pas procesit të pjesëmarrjes nëpër konferenca/stërvitje si dhe sigurohet që të kenë qasjen përkatëse në informacion (sipas nivelit të klasifikimit të informacionit).
- Inicion aktivitete duke u koordinuar paraprakisht me G5SIIPFSK, G3SIIPFSK, DBNIEA ODC, USAREUR-AF dhe aktorë tjerë relevant në përmbushje të objektivave të KOMFSK-së.
- Merr pjesë në punëtori, aktivitete, konferenca dhe angazhime të tjera në emër të FSK-së duke përfaqësuar interesat e Forcës.

- Propozon fusha të bashkëpunimit afatshkurtër, afatmesëm dhe në koordinim SHP edhe afatgjatë mes FSK-së dhe USAREUR-AF.
- Koordinon me SHPFSK, MM, ODC, USAREUR-AF dhe EUCOM që të ketë zbatim të Planit të EUCOM-it për Republikën e Kosovës si dhe jep këshilla gjatë draftimit të tij.
- Koordinon përmes USAREUR-AF ose drejtpërdrejtë me komandat përkatëse amerikane të vendosura gjeografikisht në Evropë.
- Është përgjegjës për draftimin dhe miratimin e planit të punës së OPK-së, të cilin paraprakisht e konsulton me aktetë relevant në FSK dhe me palën pritëse USAREUR-AF;
- Kryen detyra dhe angazhime tjera sipas udhëzimeve të zinxhirit komandues.

Kriteret për konkurrim ;

- Të jetë pjesëtar aktiv i FSK-së;
- Të ketë gradën Major apo Nënkolonel;
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze në nivelin STANAG 6001, niveli 3.2.3.2 ose ekuivalent sipas sistemit të testimit që e realizon FSK-ja, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Të posedojë certifikatën e sigurisë;
- Të mos ketë ndonjë masë aktive për shkelje disiplinore;
- Në kohën kur planifikohet marrja e detyrës, të ketë më shumë se tri (3) vjet shërbim para daljes në pension të rregullt;
- Njohja e gjuhës së shtetit pranues dhe shkollimi ushtarak ose civil në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare konsiderohet përparësi.
- Preferohet të ketë të përfunduar Kursin e Komandës dhe Shtabit (CGSG) në/me SHBA (për Republikën Federale të Gjermanisë).

Kohëzgjatja e emërimit;

- Mandati i Përfaqësuesit Ushtarak (PU) në Shtete e Bashkuara të Amerikës është dy (2) vite, ndërsa në Republikën Federale të Gjermanisë është një (1) vit. Në rast të veçanta Ministri i Mbrojtjes në konsultim me KOMFSK-në ka të drejtë që Përfaqësuesit Ushtarak (PU) t'ia vazhdojë mandatin më së shumti deri në 6 (gjashtë) muaj.
- Pas përfundimit të shërbimit, Përfaqësuesi Ushtarak (PU) rikthehet në strukturën e Forcës së Sigurisë së Kosovës në pozitën e caktuar në Tabelën Organizative të Personelit (TOP), përmes procedurave dhe dispozitave përkatëse në fuqi.

Afati për konkurrim;

- Konkursi është i hapur nga data **22.06.2026** deri më **01.07.2026**.

Si të aplikoni;

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe nënshkruajnë formularin e aplikimit i cili duhet të dorëzohet në Sektorin e Rekrutimit në Departamentin për Politika të Personelit dhe Rekrutimit personalisht, çdo ditë pune nga ora 09: 00-15: 00 deri në afatin e fundit të aplikimit. Formularët e aplikimit do të jenë në dispozicion në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes mod.rks-gov.net ku gjindet shpallja e konkursi. Kandidatët mund të bashkëngjitin kopjet e dokumenteve / certifikatave / gradave të marra kohët e fundit dhe të cilat nuk janë regjistruar ende në dosjen e tyre personale.

Për informacion shtesë, kandidatët mund t'i drejtohen Departamentit për Politika të Personelit dhe Rekrutimit/Sektorit të Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtjes, në numrin e telefonit 038 -200 - 13-508.

Ministria e Mbrojtjes ofron mundësi të barabarta për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikimet e tyre për Përfaqësues Ushtarak (PU), pavarësisht përkatësisë etnike ose gjinisë së tyre.